



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA LIGJORE
SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 25.06.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion i rrugëve, nyjeve të trafikut, trotuareve, sinjalistike në qytet në vitin 2026”.
(Marrëveshje Kuadër me një Operator Ekonomik, ku janë përcaktuar të gjitha kushtet, për një
periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore, nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Punime ndërtimi për rrugë 45233120-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

83,278,937 (tetëdhjetë e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e
shtatë) Lek pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Durrës 2026.

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve Nr.227, datë 10/06/2026, me Nr.8008 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t`u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit, dokumentet sipas Buxhetit të Bashkisë, për fondin limit, shqyrtoi dokumentet e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuara nga grupi i punës.

I. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në manualin nr.216, datë.13.4.2023, për “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, si dhe për disa zëra në çmimet e tregut me analizat përkatëse.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës të jetë: 83,278,937 (tetëdhjetë e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) Lek pa TVSH.

Afati i realizimit të punimeve është, 12 (dymbëdhjetë) muaj ose 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin të defekteve, që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit nga ana e firmës të jetë 2 (dy) vite.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 e 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP

“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP-së “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit të Shtojcës 7. (Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, nenin 39, pika 6/b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tri) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel minimal të kapacitetit ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, ajo mbështetet në Kreun V, Seksioni III, nenin 43, pikat 2 dhe 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, që përcakton mënyrën e verifikimit të kapaciteteve financiare përmes xhiros vjetore të operatorit ekonomik. Vlera e xhiros vjetore të kërkuar (jo më e vogël se fondi limit për të paktën një nga tre vitet e fundit) është vendosur në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve që parashikon kontrata marrëveshje kuadër “Rikonstruksion i rrugëve, nyjeve të trafikut, trotuareve, sinjalistike në qytet në vitin 2026”. Ky objekt kërkon financime të qëndrueshme dhe aftësi të operatorit për të përballuar flukset monetare gjatë zbatimit të kontratës që do të lidhet, përfshirë pagesat për furnizime, personel, pa penguar vijimësinë e punimeve.

Kjo kërkesë është gjithashtu në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, konkretisht me nenin 64 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data

31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”, të ndryshuar, dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Përmes këtyre dispozitave garantohej që të dhënat e xhiros të jenë të certifikuara nga autoritetet tatimore dhe të pasqyrojnë realisht qëndrueshmërinë financiare të operatorit.

Kërkesa është ligjërish e bazuar, proporcionalisht e arsyeshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, duke siguruar që operatori ekonomik të ketë potencial të mjaftueshëm financiar për zbatimin pa vonesa dhe pa risk të kontratës së: Rikonstrukcion i rrugëve, nyjeve të trafikut, trotuareve, sinjalistike në qytet në vitin 2026, marrëveshje kuadër, e cila ka rëndësi të veçantë sociale dhe komunitare.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare 2023, 2024, 2025, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteri është ligjërish i bazuar, proporcional dhe në raport të drejtë me natyrën e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata të realizohet nga operatorë që kanë aftësi reale financiare dhe organizative për zbatimin me sukses të punimeve.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument, të lëshuar nga administrata e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku ushtrojnë aktivitetin, që vërteton se kanë shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara për vitin 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, si dhe akteve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky dokument duhet të dorëzohet në sistem gjatë fazës së ofertimit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë këtë vërtetim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, në nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, përfshirë këstet e maturuara të vitit 2026, në përputhje me afatet e maturimit të detyrimeve, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Gjithashtu referuar dhe ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 74 të tij. Shlyerja e detyrimeve vendore siguron që operatori ekonomik të jetë në përputhje me legjislacionin fiskal dhe të mos ketë detyrime të prapambetura ndaj administratës vendore.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një procedure publike, ku përzgjedhja e operatorit duhet të garantojë integritet të plotë financiar dhe administrativ. Ky kriter është ligjërish i bazuar, i arsyeshëm dhe në përputhje me parimet e integritetit dhe kontrollit fiskal që kërkohen për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në kontrata publike, duke siguruar që subjektet pjesëmarrëse të jenë kontribuues aktivë dhe të ndershëm në sistemin tatimor e vendor të Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit, nga data e shpallje së njoftimit të kontratës.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si mëposhtë:

Argumentimi: *Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.*

AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të ofertuesve. Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

Për sa i përket kapaciteteve teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat janë hartuar dhe vendosur nga struktura e posaçme e specializuar, sipas urdhrit Nr.227, datë 10/06/2026, me Nr.8008 prot., të titullarit të autoritetit kontraktor e si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP - 1 A *Punime gjërmimi në tokë.*
- NP - 4 B *Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.*

- NP - 7 A *Ujësjetllës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje.*
- NP - 12 A *Punime të inxhinierisë mjedisore*
- NS - 18 A *Punime topogjeodezike.*

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi. Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP - 1	Punime gjërmimi + sistemimi në tokë	Punime gjërmim dheu	A (0-20 milion lekë) Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv
NP - 4	Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tram vai, metro, pista aeroportuale	Punime rrugore	B (101-200 milion lekë) Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv

NP-7	Ujesjellesa,gazjellesa,vajsjellesa,vepra kullimi e vaditje	Punime KUB + KUZ	A (0-20 milion lekë) Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv
NP-12	Punime te inxhinierise mjedisore	Punime per mbrojtjen e skarpatave nepermjet mureve mbajtese nga fenomenet erozive	A (0-20 milion lekë) Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv
NS - 18	Punime topogjeodezike	Zbatimi i rilevimeve topografike, punimeve topogjeodezike etj.	A (0-20 milion lekë) Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese, si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| a. Inxhinier Ndërtimi profil Infrastruktura Transporti | 1 (një) |
| b. Inxhinier Gjeodet (Topograf) | 1 (një) |
| c. Inxhinier Gjeoteknik | 1 (një) |
| d. Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| e. Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| f. Arkitekt | 1 (një) |

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për stafin e sipërcituar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës individuale, të vlefshme.
- Diplomën përkatëse.
- Të paraqitet listpagesat e E-Sig të shoqërisë, minimalisht për periudhën muajin e fundit të deklaruar, ku duhet të figurojnë punonjësit e mësipërm.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr.42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndërtimit Infrastruktura Transporti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve duke qenë se punimet kanë të bëjnë me punime rrugore në të cilat është e nevojshme prania e një Inxhinier Transporti për përvojën e tij në punimet në rrugë.
- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, matjet topografike, azhornimet etj referuar punimeve të parashikuara në preventiv., me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standardeve.
- **Inxhinieri Gjeoteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve gjeoteknike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv., me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standardeve. Punimet kanë të bëjnë edhe me gërmime në zona të ndryshme të qytetit dhe shkenca e dherave janë një njohuri e nevojshme për punimet rrugore në akset në të cilat po kryhen punimet. Duke qenë se kemi të bëjmë me një marrëveshje kuadër mund të dalin punime të paparashikuara të cilat kanë nevojë për inxhinier gjeoteknik.

- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve të cilat kanë të bëjnë me ndriçimet dhe punimet ku kërkohen prania e Inxhinier Elektrik për zbatimin me përgjegjësi të punimeve.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve KUB dhe KUZ prania e tij është e nevojshme për zbatimin e këtyre punimeve.
- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet referuar faktit që kemi të bëjmë me punime të ndryshme të ndara në zona të ndryshme dhe duke patur ndërhyrjen në infrastruktura të ndryshme kërkohet prania e Arkitektit për punime cilësore dhe në përputhje me zonën.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin inxhinierik (jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë), si mëposhtë:

a. Inxhinier Hidrogeolog	2 (dy)
b. Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
c. Inxhinier Topograf	1 (një)

Operatori ekonomik për stafin e mësipërm duhet të paraqesë: kontratë pune të vlefshme, diploma përkatëse, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën muajin e fundit të deklaruar.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve që konkretisht i përkasin ndërtimit të trupit të rrugës, si hedhjen e shtresës së cakëllit, stabilizantit si dhe shtresat e tapetit si asfalt dhe binder apo edhe për rrugën. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve konkretisht cakëll, stabilizant binder dhe asfalt.

- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, matjet topografike, azhornimet etj referuar punimeve të parashikuara në preventiv., me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standardeve.
- **Inxhinieri Hidrogeolog** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve Analizon ndikimin e ujërave nëntokësore mbi strukturën e rrugës, duke ndihmuar në parandalimin e dëmtimeve që mund të vijnë nga infiltrimi apo lagështia e vazhdueshme duke ju referuar dhe faktit se kemi zona ku kemi të bëjmë me filtrime të vazhdueshme të ujërave është e nevojshme prezenca e inxhinierit Hidrogeolog në zbatimin e punimeve

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë gjithashtu:

- a. Minimumi 1 (një) person që përmbush kriteret për të qenë **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, pajisur me certifikatë lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Minimumi 1 (një) **“Ekspert Zjarrfikës”** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.
- c. Minimumi 1 (një) **“Mjek”**, të paraqiten Kontratë të vlefshme pune, Urdhër mjeku, Diplomë si dhe të figurojë në listëpagesë për periudhën muajin e fundit të deklaruar. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, duket që ky kriter të plotësohet duke marrë në konsideratë numrin e punonjësve në total, në zbatim të VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.
- d. Minimumi 1 (një) **Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore**, i certifikuar sipas VKM nr. 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e. Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore" dhe Udhëzimit Nr.9 date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore.
- e. Minimumi 1 (një) **Arkitekt Peisazhi**, pajisur me certifikatë lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- f. Minimumi 1 (një) **Inxhinier Materialesh**, pajisur me certifikatë lëshuar nga organe të akredituar të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- g. Minimumi 1 (një) **Inxhinier Mjedisi pajisur me VNM (Vlerësimi Ndikimit Mjedisi)**, i certifikuar sipas Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011. Certifikata VNM lëshuar nga Ministria e

Mjedisit.

- h. Minimumi 2 (dy) Saldator për punime në prani uji sipas UNI EN ISO 15618-1**, certifikata e vlefshme dhe e lëshuar nga institucione të akredituara të njohura nga Republika e Shqipërisë. UNI EN ISO 15618-1:2016 është një standard teknik evropian / ndërkombëtar për kualifikimin dhe certifikimin e saldatorëve prani ujë (underwater welders) që bëjnë saldim në ambient hiperbarik të lagësht (hyperbaric wet welding), kryesisht mbi çelik.
- i. Minimumi 3 (tre) Saldator për punime speciale saldimi sipas EN 9606:1**, certifikata e vlefshme dhe e lëshuar nga institucione të akredituara të njohura nga Republika e Shqipërisë. Saldator për punime speciale saldimi sipas EN ISO 9606-1 do të thotë një saldator i kualifikuar dhe certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1, i cili mbulon testimin e saldatorëve për saldim me shkrirje të çelikut (fusion welding of steels).

Operatori ekonomik për punonjësit e mësipërm duhet të paraqesë: kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Kërkesa për **Audituesi/Inspektuesi i Sigurisë Rrugore** bazohet në VKM nr. 125, datë 23.02.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore” Ky vendim: Vendosi politikat kombëtare për uljen e aksidenteve rrugore Përcakton objektiva konkrete për përmirësimin e sigurisë thekson nevojën për: menaxhim të sigurisë së infrastrukturës përdorimin e auditimeve të sigurisë rrugore e konsideron auditimin si mjet kyç parandalues.

Inspektuesi i sigurisë rrugore është përgjegjës për vlerësimin, analizimin dhe rekomandimin e masave për të përmirësuar sigurinë në rrugë. Ky profesion përqendrohet në identifikimin dhe

parandalimin e rreziqeve të lidhura me trafikun rrugor, për të garantuar mbrojtjen e jetës dhe reduktimin e aksidenteve. Inspektimi i Infrastrukturës Rrugore Kontrolli i Rrugëve dhe Sinjalistikës: Vlerësimi i gjendjes fizike të rrugëve, përfshirë trotuaret, ndarëset dhe korsitë. Verifikimi i dukshmërisë dhe funksionalitetit të sinjalistikës horizontale dhe vertikale. Inspektimi i Pajisjeve të Sigurisë: Kontrolli i barrierave mbrojtëse, ndriçimit rrugor dhe pajisjeve të tjera të sigurisë. Vlerësimi i Rreziqeve Lokale: Identifikimi i zonave me rrezik të lartë aksidentesh (p.sh., kthesa të mprehta, udhëkryqe të pasigurta). Vlerësimi dhe Menaxhimi i Rreziqeve Analiza e Rreziqeve: Studimi i faktorëve që kontribuojnë në aksidente, si kushtet e rrugës, trafiku dhe sjellja e shoferëve. Përdorimi i statistikave të aksidenteve për të identifikuar tendencat dhe pikat problematike. Krijimi i Planeve të Menaxhimit të Rreziqeve: Propozimi i masave për të reduktuar aksidentet, si përmirësimi i sinjalistikës, rregullimi i korsive apo ndërtimi i rrethrotullimeve. Auditimi i Projekteve të Infrastrukturës Vlerësimi i Projekteve të Reja: Analiza e planeve dhe projekteve të ndërtimit të rrugëve për të siguruar që ato përmbushin standardet e sigurisë rrugore. Auditimi i Rrugëve Ekzistuese: Shqyrtimi i rrugëve të ndërtuara ose të rinovuara për të identifikuar problemet e sigurisë. Sigurimi i Përputhshmërisë. Kontrolli që projektet përputhen me rregulloret dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Testimi dhe Monitorimi Testimi i Sigurisë në Terren: Simulimi i lëvizjes së trafikut për të analizuar ndikimin e ndryshimeve në rrugë.

Kërkesa për Arkitektin e peisazhit Në Shqipëri, për realizimin e punimeve në lulishte dhe mbjelljen e pemëve, është e nevojshme të angazhohet një arkitekt peizazhi. Në rastin e punimeve peizazhore, përfshirja e një arkitekti peizazhi është e justifikuar dhe shpesh e detyrueshme, për të hartuar projektin teknik dhe për të mbikëqyrur zbatimin e tij. Ligji Nr. 10171/2009 “Për rregullimin e profesionit të arkitektit dhe inxhinierit”, i ndryshuar: Një projekt që përfshin ndërhyrje në territor, peizazh apo ambient, duhet të hartohet nga personel i licencuar në fushën përkatëse, pra arkitekt peizazhi në këtë rast duke u shfaqur nevoja për zbatimin e punimeve sa më të mira. Duke parë që ne Projekt idene e hartuar nuk ka qenë pjesë e grupit të projektimit një Arkitekt Peisazhi ne e gjejmë të arsyeshme praninë e tij gjatë fazës së zbatimit për të bërë të mundur ndjekjen dhe realizimin sa më të mirë të punimeve. -Në zbatim të preventivit të parashikuara në projektin e zbatimit për kompletimin e veprës, është parashikuar edhe sistemimi nepermjet punimeve të ndryshme. Arkitekti i peisazhit është i nevojshëm për të siguruar integritetin harmonik të infrastrukturës rrugore me mjedisin urban, përmes projektimit dhe sistemit të hapësirave të gjelbra, elementeve dekorative dhe trajtimit estetik të zonave përreth, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe të imazhit urban të zonës së ndërhyrjes.

Kërkesa për Inxhinier Materiale është përgjegjës për projektimin, zhvillimin, testimin dhe menaxhimin e materialeve të përdorura në produkte dhe struktura të ndryshme. Ky profesion kombinon shkencën e materialeve me inxhinierinë për të krijuar materiale me performancë të lartë për aplikime specifike. **Ky specialist** është i nevojshëm për të garantuar përzgjedhjen, kontrollin dhe verifikimin e cilësisë së materialeve që do të përdoren në punimet e rikonstruksionit rrugor, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike, standardet në fuqi dhe kërkesat e projektit, me qëllim realizimin e një infrastrukture të qëndrueshme dhe me jetëgjatësi të lartë.

Kërkesa per **Inxhinier Mjedis** (specializuar per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe auditimin mjedisor), do te jete pergjegjes per te gjitha punimet qe perfshijne Inxhinierine e Mjedisit. Ky kriter vjen si rezultat i punimeve ne nje qender te banuar, me kohezgjatje punimesh relativisht te larte dhe Vleresimi I Ndikimit ne Mjedis do te ofroje mundesine e sigurimit te mbrojtjes se larte te mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem, permes perfshirjes se ceshtjeve te mjedisit me pasoja sa me minimale te mundshme negative ne mjedis. **Inxhinieri i Mjedisit** është i nevojshëm për të identifikuar, vlerësuar dhe monitoruar ndikimet e mundshme mjedisore që mund të shkaktohen gjatë zbatimit të punimeve, duke siguruar përputhshmërinë e projektit me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe zbatimin e masave për minimizimin e efekteve negative në mjedis.

Kërkesa per **Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune** Kërkesa mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. **Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune** është i domosdoshëm për realizimin e kontratës së rikonstruksionit të rrugëve urbane, pasi garanton zbatimin e masave të sigurisë në kantier, mbrojtjen e punonjësve dhe përdoruesve të rrugës, si dhe respektimin e kërkesave ligjore dhe standardeve teknike në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë

Kërkesa per **Ekspert Zjarrfikës** Prania e një eksperti zjarrfikës në kantier pune është thelbësore për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e jetës dhe pronës, si dhe për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret ligjore. Më poshtë paraqiten disa argumente që mbështesin këtë kriter: 1. Parandalimi i zjarreve Identifikimi i rreziqeve të zjarrit: Eksperti zjarrfikës analizon kantierin për të identifikuar burimet e mundshme të zjarrit, si mjetet elektrike, materialet e ndezshme ose gabimet në instalime. Masat parandaluese: Ai vendos dhe zbaton masa për të parandaluar ndezjen, përhapjen dhe eskalimin e zjarreve, duke siguruar që mjedisi të jetë sa më i sigurt. Reagimi i shpejtë në raste emergjente. Menaxhimi i incidenteve: Nëse ndodh një zjarr, eksperti zjarrfikës është i trajnuar për të ndërhyrë menjëherë, duke minimizuar dëmet dhe duke shpëtuar jetët. Koordinimi i evakuimit: Ai krijon dhe zbaton plane të qarta evakuimi, duke udhëzuar punonjësit në mënyrë efektive gjatë një emergjence. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i punonjësve. Trajnimi i stafit: Eksperti zhvillon trajnime të rregullta për punonjësit mbi përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit (si shuarësit e zjarrit), protokollet e evakuimit dhe sjelljen e duhur në situata emergjente. Ndërtimi i kulturës së sigurisë: Ai rrit ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse ndaj zjarreve. Mbikëqyrja e pajisjeve dhe sistemeve kundër zjarrit Inspektimi i rregullt: Eksperti kontrollon pajisjet kundër zjarrit në kantier (shuarësit, hidrantët, sensorët e tymit etj.) për të siguruar funksionimin e tyre të duhur. Instalimi dhe mirëmbajtja: Ai siguron që të gjitha pajisjet dhe sistemet të jenë instaluar sipas standardeve dhe të mirëmbahen rregullisht.

Përputhshmëria me legjislacionin dhe standardet Respektimi i rregulloreve: Eksperti zjarrfikës siguron që kantieri të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë ndaj zjarrit. Dokumentimi: Ai krijon raporte dhe mbikëqyr dosjet teknike që tregojnë përputhshmërinë e kantierit me normat e sigurisë

*Kërkesa për **Mjekun** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësinë që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek .*

*Kërkesa për **Saldator për punime ne prani uji** sipas UNI EN ISO 15618-1 UNI EN ISO 15618-1:2016 është një standard teknik europian / ndërkombëtar për kualifikimin dhe certifikimin e saldatorëve prani ujë (underwater welders) që bëjnë saldim në ambient hiperbarik të lagësht (hyperbaric èet èelding), kryesisht mbi çelik. Referuar zërit të çelikut është e nevojshme prania e saldatorit sipas certifikimit të mësipërm për të garantuar cilësinë e duhur për zërin e preventivit. Ky specialist është i nevojshëm për realizimin e sigurt dhe cilësor të punimeve të saldimit në mjedise me praninë e ujit ose lagështisë së lartë, duke garantuar përputhshmërinë me standardet teknike ndërkombëtare, integritetin strukturor të elementeve metalike dhe minimizimin e rreziqeve gjatë zbatimit të punimeve.*

*Kërkesa për **Saldator për punime speciale saldimi** sipas EN 9606:1 Certificate e vlefshme si dhe të figuroje në listepagesa për periudhën e kërkuar Saldator për punime speciale saldimi sipas EN ISO 9606-1 do të thotë një saldator i kualifikuar dhe certifikuar sipas standardit EN ISO 9606-1, i cili mbulon testimin e saldatorëve për saldim me shkrirje të çelikut (fusion èelding of steels). Ky **specialist** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të specializuara të saldimit në elemente metalike me kërkesa të larta teknike, duke garantuar cilësinë e bashkimeve të salduara, sigurinë strukturore të konstruksioneve dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të zbatimit dhe kontrollit të cilësisë. Në përputhje me projektin dhe preventivin për strukturën metalike të pusëtave tobinove etj sipas rastit të kërkuar në marrëveshjen kuadër*

2.3.6 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, germa b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te një drejtuesi teknik te shoqërisë por dhe si orientim për një person kontakti dhe ure lidhëse mes mbikëqyrësit te punimeve dhe AK për problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, sipas profileve të mëposhtme:

- a. 2 (dy) Teknik i mesëm Ndërtimi (Diplome e shkollës mesme)
- b. 2 (dy) Teknik i mesëm Topograf/Gjeometër (Diplome e shkollës mesme)
- c. 1 (një) Teknik i mesëm Hidroteknik (Diplome e shkollës mesme)
- d. 1 (një) Teknik i mesëm Elektroteknik (Diplome e shkollës mesme)

- e. 1 (një) Teknik i mesëm Mekanik (Diplome e shkollës mesme)
- f. 5 (pesë) Punonjës Asfalti (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- g. 3 (tre) Hekurkthyes (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- h. 3 (tre) Karpentier (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- i. 3 (tre) Hidraulik (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- j. 3 (tre) Elektracist (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- k. 3 (tre) Betonues (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- l. 3 (tre) Saldator (Me Certificate Trajnimi / Diplome)
- m. 14 (katërbëdhjetë) punëtor të thjeshtë

Operatori ekonomik për punonjësit e mësipërm duhet të paraqesë: Kontratat individuale të punës të vlefshme, Diplome e shkollës mesme/ Certificate Trajnimi si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën muajin e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Teknik i mesëm Ndërtimi referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.

Teknik i mesëm Topograf referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe matjeve duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të

projektit gjithashtu është kërkuar me qëllim realizimin e rilevimeve topografike te domosdoshme gjatë zbatimit.

Teknik i mesëm Eletroteknik referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik te punimeve elektrike te ndriçimit etj.

Teknik i mesëm Hidroteknik referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik te punimeve hidroteknike duke përfshirë këtu tobinot, pusetat etj.

Teknik i mesëm Mekanik referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të tubove te celikut nyjeve lidhëse, etj.

Betonues referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve të hapjes së betonit dhe procesit te betonimit. Kerkesa per numrin lidhet referuar sasisë dhe grafikut te punimeve dhe faktit qe punimet do kryhen ne segmente te njëjta per te arritur eficiencen dhe kohen.

Hekurkthyes referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me eficensë të punimeve te hekurit.

Karpentier bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve te vendosjes se armaturës për punimet e betonit

Hidraulik bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve hidraulike KUZ + KUB

Punonjës asfalti bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve te asfaltit.

Elektracist bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve elektrike te ndriçimit.

Saldator bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve saldimi për vendosjen e tabelave apo saldimi të armimit te pesetave nëse do të ketë problematika gjatë zbatimit të marrëveshjes kuadër.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të kualifikuar për kryerjen e punimeve, te cilët duhet të jenë të pajisur me Dëshmi te Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional, sipas profileve te më poshtme:

a. Eskavatorist 3 (tre)

- b. Buldozerist 3 (tre)
- c. Automakinist 3 (tre)
- d. Shofer kamioni 5 (pesë)

Operatori ekonomik për punonjësit e mësipërm duhet te paraqesë: Dëshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mësipërme.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet te paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë manovratorët, automakinistet dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”,*

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me dokumentet e tenderit). Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standardeve të përcaktuara në specifikimet teknike.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 80 (tetëdhjetë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë:

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën muajin e fundit të deklaruar.

b) Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar.

Numri prej 80 punonjës përfshin 14 punëtorë të thjeshtë + 66 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, manovratore, hidraulikë dhe profesioniste të tjerë të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu për llogaritjen e numrit të punonjësve janë marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 15-20 ton	2 cope	Pronësi ose me qira
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	2 cope	Pronësi ose me qira

Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 8-10 ton	2 cope	Pronësi ose me qira
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	2 cope	Pronësi ose me qira
Kamion me vinc	2 cope	Pronësi ose me qira
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 1.5-2 ton	2 cope	Pronësi ose me qira
Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronësi ose me qira
Grejder me goma (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronësi ose me qira
Minifadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronësi ose me qira
Damper me goma me kapacitet mbajtes 4-6 ton (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronësi ose me qira
Minieskavator deri ne 5 ton (mjet teknologjik)	1 cope	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	3 cope	Pronësi ose me qira
Autopompe betoni	2 cope	Pronësi ose me qira
Rrul gome-hekur 8-10 ton	2 cope	Pronësi ose me qira
Rrul gome-hekur mbi 14 ton	3 cope	Pronësi ose me qira
Rrul hekur-hekur 1-3 ton	2 cope	Pronësi ose me qira
Autobot uji	1 cope	Pronësi ose me qira
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qira
Instrument per punime gjeodezike	1 cope	Pronësi ose me qira
Dumper me kapacitet mbajtes mbi 30 ton (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronësi ose me qira
Automjet per perdorim te vecante i pajisur me sonde me kamera , per kontrollin e tubacioneve te kanalizimeve te ujerave te zeza dhe te bardha ne nje gjatesi 100 metra lineare	1 cope	Pronësi ose me qira
Makineri frezimi asfalti	1 cope	Pronësi ose me qira
Pirun Teleskopik me rrotullim 360° me krahe te gjate mbi 20 m(Mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronësi ose me qira
Fabrike Betoni pajisur me QKL	1 cope	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi

Ofertuesi për makineritë/mjetet, të cilat janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.

Ndërsa për mjete të marra me qira/kontrate bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/ bashkëpunimit.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/ Kontrate Bashkëpunimi.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtyre kërkesave, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre.

- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 15-20 ton sipas zërit të preventivit 3.104/b; 3.164/1b; 3.212/b; etj.
- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 8-10 ton sipas zërit të preventivit 3.104/b; 3.164/1b; 3.212/b; etj.
- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton sipas zërit të preventivit 3.104/b; 3.164/1b; 3.212/b; etj.
- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton sipas zërit të preventivit 3.104/b; 3.164/1b; 3.212/b; etj. kapaciteti i kërkuar i këtyre kamionçinave referohet rrugicave në të cilat do hasen vështirësi nga hyrja e mjeteve të renda
- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton sipas zërit të preventivit 3.158/5a; 3.An.1641b; 3.212/b; kapaciteti i kërkuar i këtyre kamionçinave referohet rrugicave në të cilat do hasen vështirësi nga hyrja e mjeteve të renda
- Eskavator me goma sipas zërit të preventivit 3.89/b kërkesa për numrin e eskavatoreve është bazuar në sasinë dhe në numrin e rrugicave të cilat do punohen paralelisht
- Grejder me goma (mjet teknologjik me goma) sipas zërit të preventivit 3.1641b; 3.212/b ,3.207/1

kërkesa për numrin e grejderëve është bazuar ne sasinë dhe ne numrin e rrugicave te cilat do punohen paralelisht

- Minifadrome me goma (mjet me goma) sipas zërit te preventivit 3.164/1b; 3.212/b; kërkesa për numrin e minifadromave eshte bazuar ne sasinë dhe ne numrin e rrugicave te cilat do punohen paralelisht.
- Damper me goma me kapacitet mbajtës 4-6 ton sipas zërit te preventivit 3.104/b; 3.164/1b; 3.212/b; etj
- Minieskavator deri ne 5 ton sipas zërit te preventivit 3.89/b kërkesa për minieskavatorin referohet arsyes për zonat dhe rrugicat e ngushta ku mund te haset vështirësi për eskavaroret me goma.
- Autobetoniere sipas zërit te preventivit 3.244 kërkesa për numrin e autobetoniereve lidhet me faktin qe punimet do kryhen ne segmente te ndryshme dhe te garantohet efikasiteti për zbatimin e punimeve
- Autopompe betoni sipas zërit te preventivit 3.244 kërkesa për numrin lidhet ngushtësisht me numrin e autobetoniereve
- Rrul gome-hekur 8-10 ton u referohet analizave 3.164/1b; 3.212/b
- Rrul gome-hekur mbi 14 ton u referohet analizave 3.164/1b; 3.212/b
- Rrul hekur-hekur 1-3 ton u referohet analizave 3.164/1b; 3.207. Kjo makineri siguron densitet të lartë dhe qëndrueshmëri të shtresave, ul boshllëqet e ajrit në material, duke rritur jetëgjatësinë e rrugës dhe garanton sipërfaqe të rrafshët dhe cilësore.
- Autobot uji u referohet zërave 3.An.1641b; 3.212/b
- Autobetoniere sipas zërit te preventivit 3.244;
- Autopompe betoni sipas zërit te preventivit 3.244;
- Saldatrice sipas zërit te preventivit 2.493/1;
- Instrument për punime gjeodezike
- Dumper me kapacitet mbajtës mbi 30 ton (mjet teknologjik me goma) sipas zërit te preventivit 3.104/b; 3.164/1b; 3.212/b;
- Automjet për përdorim te veçante i pajisur me sonde me kamera, për kontrollin e tubacioneve te kanalizimeve te ujerave te zeza dhe te bardha ne nje gjatësi 100 metra lineare I referohet punimeve KUB + KUZ arsyeja pse kërkohet mjeti i tille është për te kontrolluar tubacionet me te cilat do punohet. Ky mjet mundëson diagnostikim të saktë dhe të detajuar të infrastrukturës ekzistuese, shmang nevojën për hapje të menjëhershme të gërmimeve, ul kostot dhe kohën e inspektimit, si dhe rrit sigurinë gjatë kontrollit të rrjeteve nëntokësore duke minimizuar ndërhyrjet fizike në terren.
- Pirun Teleskopik me rrotullim 360° me krahe te gjate mbi 20 m (Mjet teknologjik me goma) Krahu teleskopik mbi 20 metra lejon vendosjen ose ngritjen e ngarkesave avantazhet e ketij mjeti jane ka lëvizshmëri më të madhe në terrene të vështira. Mund të përdoret si vinç, pirun ngritës ose platformë pune duke ndërruar aksesorët. Kërkon më pak hapësirë operimi. Është shumë praktik për punime urbane dhe infrastrukture.
- Instrument për punime gjeodezike është kërkuar për matje topografike në terren, për piketimin e objekteve dhe akseve të projektit, për kontrollin e kuotave dhe deformimeve gjatë punimeve ndërtimore, si dhe për krijimin e hartave dhe planeve gjeodezike me saktësi të lartë, duke siguruar korrektësinë e zbatimit të projektit në terren.
- Fabrike Betoni pajisur me QKL / mobile e lëvizshme, jo më larg se 30 km nga vendi i punimeve sipas zërit te preventivit 3.244.

Argumentim teknik për distancën e transportit të betonit Distanca prej 30 km nga objekti argumentohet bazuar në qëndrueshmërinë (viskozitetin) e materialit të betonit i cili duhet të ruaj parametrat teknik përpara hedhjes në vepër. Nëse distanca e transportit të betonit do të jete më e madhe se 60 min deri në vepër, kjo do të krijonte dëmtim të materialit dhe ulje të markës

Mjetet e mësipërme kërkohen duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- a. Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- b. Certifikatë **ISO 45001:2018** mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim
- c. Certifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.
- d. Certifikatë **ISO 39001:2012** mbi “Sistemi menaxhimit të sigurisë rrugore”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.
- e. Certifikatë **ISO 3834-2:2021** mbi “Sistemet e menaxhimit të saldimit”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.
- f. Certifikatë **ISO EN1090-1+A1:2011** mbi “Sistemet e menaxhimit të konformitetit të strukturave të celikut dhe alimunit” (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit, duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Akt – Marrëveshjes). Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe bazuar në nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

- a) Për ISO 9001 - 2015; Kjo certifikatë specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqenëse Bashkia Durrës si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kryhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standard cilësie.
- b) Per ISO 14001 – 2015: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standardin ISO 14001 – 2015, standard ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësi ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë.
- c) Per ISO 45001:2018: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standardin ISO 45001:2018, standard ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standardi konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare
- d) Per ISO 39001:2012: Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standardin ISO 45001:2018, standard ky që përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikën më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund të ndihmojë për të vënë në vend politikat, procedurat dhe kontrollet e nevojshme për çdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare
- e) Per ISO 3834-2:2021 Është kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standardin ISO 3834-2:2021, standard ky që përcakton rëndësinë dhe fushëveprimin e produkteve kritike të sigurisë, kompleksi i prodhimit, koha e përdorimit të prodhimeve të prodhuara, sfera e

problemeve metalurgjike që mund të ndodhin, defektet, deformimet ose defektet e saldimit që ndikojnë në performancën e produktit në kuptimin e fushës së kualitetit të detajuar, standard dhe themelor të cilësisë.

- f) Për ISO EN1090 Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standardin ISO EN1090, (certifikate për strukturat e çelikut dhe te aluminit) Ky standard evropian specifikon kërkesat për vlerësimin e konformitetit të karakteristikave të performancës për komponentët strukturorë të çelikut dhe aluminit, si dhe për kompletet e vendosura në treg si produkte ndërtimi. Vlerësimi i konformitetit mbulon karakteristikat e prodhimit, dhe sipas rastit, karakteristikat e projektimit strukturor. Ky standard evropian mbulon gjithashtu vlerësimin e konformitetit të komponentëve të çelikut të përdorur në strukturat e përbëra prej çeliku dhe betonit.

2.4.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga QKB me Kodin III.2.B - Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta, së bashku me aktin e miratimit dhe kodet 17 05 04, 17 09 04, 19 13 04, 20 02 02, 20 03 06, në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë të përcaktuara sipas pikës 10 germa “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Për sa i takon kërkesës për Lejen Mjedisore me **Kod III.2.B** “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve te llojeve te ndryshme” bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku specifikohet se : “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit

teknik dhe Specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontratës, metodat e punës qe duhet te aplikohen nga zbatuesi duhet te synojnë ne minimizimin ose nëse është e mundur ne ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet te tregojë një kujdes maksimal ne transportin e mbetjeve inerte qe dalin gjatë punimeve dhe gërmimeve si transportin e tyre, me qellim mbrojtjen maksimale te mjedisit dhe Vendimit te Këshillit të Ministrave Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar si dhe është bazuar ne projekt-preventivin.

2.4.3 Operatori ekonomik ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës te publikuar ne DST, për materialet si më poshtë:

- a. **Materiale Sinjalistike, Tabela** Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet katalogët përkatës Certifikat Konformitetit sipas ISO EN 55015:2006 EN 61547:2009 EN 61000-3-2:2006 , Raportet e Testimit si dhe ISO 9001/ekuivalente për cilësinë.
- b. **Tubat e brinjëzuar HDPE.** Tubat e brinjëzuar HDPE duhet të jenë nga material polietileni, me densitet të lartë, në përputhje me standardin EN 13476 dhe EN 1610 ose ekuivalente. Tubat duhet te kenë fleksibilitet te mire dhe veti te mira hidraulike dhe mekanike .Duhet te jene te përshtatshme per te gjitha punimet ne sistemet e kullimit dhe ujerave te zeza për instalime nëntokësore me rezistence te larte kimike sipas klasifikimit te standardit ISO 10358 ose ekuivalente. Gjatësia e tubave duhet te ketë gjatësi standarde 6m dhe bashkimi i tyre te jete me bashkues me gomine EPDM ose SAG Tubat duhet te kenë këto karakteristika materiali: HDPE Standardi: DIN 4262/1 ose ekuivalente Dendësia: >0.945 kg/m³ Moduli i elasticitetit:>800MPa Koficienti i zgjerimit termik linear:1013Ω Forca e unazes: Sipas standardit EN ISO 9969 ose ekuivalente. Ngjyra: E zeze Tubat hdpe te brinjëzuar duhet te jene te certifikuar nga një institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar i akredituar, e cila të vërtetojë qe tubat hdpe korrogato janë projektuar për kullime nëntokësore nënpresion ne sistemet e kanalizimeve.
Duhet te paraqiten: Katalogët/ skedat teknike te shoqëruara me Certificate Konfirmiteti CE/Deklarata Performance lëshuar nga prodhuesi.
- c. **Boje Bikomponente Spray** Bojë sinjalistike dy komponentë me bazë metil metakrilati për vizimin e rrugëve, fushave sportive etj Densiteti: 1.75 ± 0.06 kg/dm³ (200C) Përmbajtje solide: Minimumi 99.8 peshë % pas hedhjes së katalizatorit dhe përfundimit të reaksionit. Produkti duhet te përmbushë specifikimet teknike në përputhje me Standardin ISO SSH: EN 12802 ose ekuivalente.
Duhet te paraqiten: Katalogët/skedat teknike te shoqëruara me raportet e testimit nga laboratore te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente te akredituar me ISO 17025 ose ekuivalente

Duhet te paraqesë: Autorizim te Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter vendoset bazuar në zërat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rëndësisë se veçantë te objektit te prokurimit, duke marre ne konsiderate se rëndësinë e zonës ku do te kryhen punimet që është zonë urbane me lëvizshmëri të lartë të automjeteve këmbësoreve mjeteve të rënda shfaqet e nevojshme qe për mallrat qe do te përdoren ne realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor te garantohet qe këto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar. AK duhet te jete i garantuar se operatori ekonomik ka garancinë e furnizimit me këto produkte ne sasinë dhe kohen e duhur për realizimin e veprës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike të hartuar për objektin “Rikonstruksion i rrugëve, nyjeve të trafikut, trotuareve, sinjalistike në qytet në vitin 2026” janë përgatitur në përputhje me standardet kombëtare të ndërtimit (STASH, ASTM) dhe në praktikën e konsoliduar të ndërtimit rrugor, duke përcaktuar në mënyrë të saktë dhe të verifikueshme kërkesat ndaj materialeve, proceset e prodhimit, shtrimit e ngjeshjes, si dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë si dhe me kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, dhe aktet nënligjore përkatëse. Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim përcaktimin e qartë dhe të plotë të kërkesave teknike për realizimin e objektit, duke garantuar cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri të punimeve. Përmes tyre sigurohet që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë informacion të njëjtë dhe të krahasueshëm për mënyrën e ekzekutimit të punimeve, materialet që do të përdoren dhe kriteret e kontrollit të cilësisë, në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe zbatimit korrekt të kontratës marrëveshje kuadër.

Shënim: Në çdo kërkesë te preventivit apo specififikimet teknike, ku është shënuar marka, cilësi e parë e materialit shtohet fjale “ekuivalente e saj”.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit